



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 216, Datë 20.12.2019

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “AXPO ALBANIA” SH.A., NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma d) të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma e), nenit 5 pika 1, germa e) dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 115/3 Prot., datë 12.12.2019, për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë “AXPO ALBANIA” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 174, datë 07.11.2019, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë “AXPO ALBANIA” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria “AXPO ALBANIA” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 459/1 Prot, datë 22.10.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje, është kryer njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 32/49, datë 08.11.2019, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palë të treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “AXPO ALBANIA” sh.a..
- Me shkresën nr. 459/2 Prot, datë 12.11.2019, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, me shkresat protokolluar në ERE me nr. 459/3 Prot., datë 20.11.2019 dhe nr.459/4 Prot., datë 02.12.2019, shoqëria “AXPO ALBANIA” sh.a. ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar.
- Kjo shoqëri është regjistruar pranë QKB, në datën 22.04.2005, me statusin e shoqërisë aksionare (sh.a.), konform legjislacionit në fuqi dhe mban numër identifikimi (NUIS) K51628010V.
- Aplikimi i shoqërisë “AXPO ALBANIA” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike” si më poshtë:
 - Formatimi dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, gërmat a), b), c) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat a), b), c), d), e) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat a), b), c), d), është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat a), b), c), d) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “AXPO ALBANIA” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI